

Vendim nr. 167 datë 13.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 13.07.2023 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 7 (M) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **MRIKE THANZA, LIBERTA THANZA, SANTILJANA THANZA, XHON THANZA, XHULJETA THANZA**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1527 (173), datë 09.05.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë nënë e bij, njëkohësisht bashkëshortja dhe fëmijët e të ndjerit Mark Thanza, si dhe të vetmit trashëgimtarë ligjorë të tij, të njohur të tillë me vendimin nr. 2572, datë 03.10.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Gjithashtu, rezulton se i ndjeri Mark

Thanza ka ndërruar jetë si pasojë e aksidentit të ndodhur në datën 09.09.2008, ku bashkë me të ka humbur jetën edhe shkaktari i aksidentit, shtetasi P.S.

2. Në këto kushte, kërkuesja Mrike Thanza i është drejtuar Byrosë Shqiptare të Sigurimeve (BSHS), duke kërkuar shpërblimin e dëmit të plotë ardhur asaj dhe fëmijëve nga vdekja e bashkëshortit, për shkak të këtij aksidenti rrugor. Rezulton se BSHS-ja ka pranuar rastin e sigurimit dhe detyrimin për të shpërblyer trashëgimtarët e të ndjerit Mark Thanza, duke i dëmshpërblyer ata me shumën 6.576.537 lekë. Kjo vlerë nuk është pranuar nga kërkuesit, të cilët me anë të kërkesëpadisë paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 21.07.2010, kanë kërkuar detyrimin e BSHS-së t'i dëmshpërblejë plotësisht për dëmin pasuror dhe jopasuror në vlerën 20.000.000 lekë, si dhe interesat për vonesën në pagimin e këtij dëmshpërblimi.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9875, datë 05.12.2011, ka vendosur: “Pranimin e padisë. Detyrimin e të paditurit, BSHS-në, t’u paguajë kërkuesve shumën 20.000.000 lekë si dëmshpërblim pasuror dhe jopasuror nga aksidenti i shkaktuar në datën 09.09.2008, si dhe vlerën e kamatëvonesave në shumën 4.255.651 lekë [...]”. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim BSHS-ja.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 224, datë 31.01.2013, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 9875, datë 05.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Detyrimin e të paditurit, BSHS-në, t’u paguajë kërkuesve dëmin e plotë pasuror dhe jopasuror në masën 11.223.122 lekë dhe interesat bankare të kësaj shume nga data e aksidentit, më 09.09.2008, deri në ekzekutimin e këtij vendimi.”. Kundër këtij vendimi kanë bërë rekurs kërkuesit.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1527 (173), datë 09.05.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

6. Në datën 13.03.2023 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1527 (173), datë 09.05.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Ky ankim kushtetues është plotësuar në datën 29.03.2023, sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000.

7. Kolegji i Gjykatës, në datën 25.05.2023, ka vlerësuar se kërkesa ishte e paplotë në drejtim të kriterit *ratione temporis* dhe se duhej t’u kthehej kërkuesve për plotësim për të paraqitur pretendimet e tyre në lidhje me këtë element, arsye për të cilën ka vendosur dhe kthimin e saj për plotësim të metash brenda 15 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

II

Pretendimet e kërkuessve

8. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimi i kundërshtuar ka cenuar:

8.1. *Parimin e sigurisë juridike lidhur me gjënë e gjykuar*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 16.07.2015 ka vendosur që rekursi përmbante shkaqet e nevojshme ligjore për kalimin e çështjes për gjykim. Nëpërmjet këtij vendimi, ai kolegji ka vlerësuar pikërisht shkaqet ligjore të paraqitjes së rekursit. Ndërkohë, një kolegji tjetër, i po së njëjtës gjykatë, shtatë vjet më vonë, e ka revokuar këtë vendim, duke e gjykuar çështjen në dhomën e këshillimit, si dhe duke vlerësuar përsëri shkaqet e rekursit. Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i datës 16.07.2015, për kalimin e çështjes për gjykim, përbën gjë të gjykuar në përputhje me ligjin e kohës kur është regjistruar rekursi dhe mund të ndryshohej vetëm nga një gjykatë më e lartë.

8.2. *Standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se sipas nenit 32 të ligjit nr. 44/2021 (që ka ndryshuar KPC-në), parashikohet se rekursi e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre. Në rastin e rekurseve, të cilat janë depozituar dhe regjistruar përpara datës së hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve, në funksion edhe të garantimit të të drejtave të palëve ndërgjyqëse, për efektet e pranueshmërisë së rekursit mbahet parasysh ligji i kohës së regjistrimit të tyre (*shih faqen 8, paragrafin 17, të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*). Ndërkohë, vendimmarrjen e tij Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka bazuar në kundërshtim me këto dispozita. Pra, Kolegji Civil citon ligjin e kohës kur është paraqitur rekursi për trajtimin e çështjes, ndërsa vendimmarrjen e bazon në ligjin që nuk ishte miratuar në kohën e paraqitjes së rekursit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual,

në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në rastin konkret, kërkuessit legjitimohen *ratione personae* për pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, kërkuessit i janë drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshtëm dhe nuk kanë më mjete për të shteruar përveç ankimit në këtë Gjykatë, për rrjedhojë e plotësojnë edhe këtë kriter.

12. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr.8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Nenet 142, pika 1 dhe 146, pika 2, të Kushtetutës, parashikojnë detyrimin për arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe shpalljen publikisht të tyre në çdo rast.

13. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës, Kolegji vëren se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuessit ka përfunduar me vendimin nr. 00-2022-1527 (173), datë 09.05.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 13.03.2023, pra pas 10 muajsh.

14. Në lidhje me këtë fakt, Kolegji i Gjykatës ka konstatuar se kërkuessit në ankimin kushtetues të tyre nuk kishin parashtruar asnjë argument për paraqitjen e ankimit kushtetues pas 10 muajsh nga dhënia e vendimit të kundërshtuar. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 31, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji, me vendimin e datës 25.05.2023, ka vendosur t’ua kthejë atyre për plotësim të metash brenda 15 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi. Ndërkohë, pas kalimit të afatit 15-ditor, kërkuessit përsëri nuk kanë sjellë asnjë argument ose provë në lidhje me këtë konstatim. Në këto kushte, Kolegji ka administruar shkresën nr. 3856/1 prot., datë 12.07.2023 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet së cilës evidentohet se vendimi i kundërshtuar nga kërkuessit është bërë i disponueshëm për palët në datën 06.07.2022 dhe është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë në datën 07.07.2022. Në këtë kuptim, Kolegji konstaton se vendimi është bërë i disponueshëm për kërkuessit në datën 07.07.2022. Duke iu referuar kësaj date, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriterin *ratione temporis*, pasi është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000,

15. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.